



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3614/prot.
1

Tiranë, më 30/08/2021

URDHËR

Nr. 373, datë 30.08.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 99, DATË 10.02.2021

“PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614, datë 30.08.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

U R D H Ë R O J:

Në Urdhrin Nr. 99, datë 10.02.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit” të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e Urdhrit riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 23:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 01.09.2021 deri në datë 14.09.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet me datë 01.09.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu